



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:050440

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874809

KPPP.nr.309/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, rruga “UÇK” nr.2, kundër debitorit “F-Dental” SH.P.K., me NUI: 810848195, me seli në Prishtinë, rruga “B” nr.6, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.389/23 të datës 17.08.2023, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “F-Dental” SH.P.K., dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.389/23 i datës 17.08.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.389/23 të datës 17.08.2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr.201912694 të datës 19.12.2022, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të përmbartjes së obligimeve nga fatura, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,500.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë, me bartjen e mjeteve financiare nga llogaria bankare e debitorit në llogarinë e veçantë bankare të kreditorit, me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit dhe pagesën e borxhit nga shitja e këtyre sendeve.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se debitori nuk e ka ushtruar veprimtarinë e biznesit që nga marsi i vitit 2020, ndërsa kreditori pa e verifikuar se a ushtron veprimtari biznese e ka ngarkuar

debitorin me taksë për biznese. Tutje ka shtuar se i njëjti ka dorëzuar arkën fiskale pranë ATK-së, gjë e cila vërtetohet nga pasqyra e llogarisë bankare ku vërehet se nuk ka pasur të hyra nga biznesi. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa procedurën përmbartimore ta pushojë.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka theksuar se dokumenti përmbartues i nxjerr në procedurë administrative është bërë i përmbartueshëm sipas rregullave me të cilat rregullohet kjo procedurë, po ashtu referimi i rasteve tek përmbartuesi privat është bërë në përputhje me LPP-në. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta vërtetoj.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se: *“Dokumentit i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar “*. Me neni 37 të LPP-së, përcaktohet se: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti, përkatësisht Fatura Nr. 201912694 e datës 19.12.2022, mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se është pranuar nga debitori në çfarëdo forme. Andaj duke qenë së debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.309/24, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.